



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 6737/prot. Datë 18.12.2020
2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 23637/prot. Datë 2312.2020
1

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 357, datë 18.12.2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 71, DATË 25.2.2020
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2020 – 2021 NË
SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

1. Në urdhrin e përbashkët nr. 71, datë 25.2.2020 “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2020 – 2021 në sistemin arsimor parauniversitar”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në shkronjën “b” të pikës 1 të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.”, zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”.
 - b) Në shkronjën “c” të pikës 2 të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.”, zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”.
 - c) Në shkronjën “d” të pikës 3 të urdhrit, togfjalëshi “... më 4 janar 2021.”, zëvendësohet me togfjalëshin “... më 11 janar 2021.”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI I ARSIMIT

SPORTIT DHE RINISË

Evis KUSHI



MINISTRI I FINANCAVE

DHE EKONOMISË

Anila DENAJ

